

V E N D I M
"PËR SEKUESTRIM LLOGARISH BANKARE"

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e perbërë nga:

GJYQTARI ALTIN SHKURTI

Asistuar prej sekretares gjyqësore **Natasha Azemaj**, në Tiranë sot me datë 21/12/2015, mori në shqyrtim materialin procedures që i përket:

KËRKUES: PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË RRETHIT GJYQËSOR TIRANË, përfaqësuar nga prokurorja Suela Salavaci

OBJEKTI: Sekuestrim i Llogarive Bankare

BAZA LIGJORE: Neni 210 i K.Pr.Penale

Gjykata pasi shqyrtoi kërkesën e prokurorit për sekuestrimin e llogarive bankare dhe bisedoi çështjen në tërësi

V Ë R E N:

Se Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka rregjistruar procedimin penal Nr. të vitit 2015.

Gjatë seancë gjyqësore rezultoi se:

Drejtoria e Pergjithshme e Parandalimit te pastrimit parave, me ane te shkreses me Nr...../1, date 18.12.2015, ka leshuar urdherin Nr....., per Bankes CREDINS SH.A., per bllokim te perkohshem te transakcioneve të shtetasit R. V. O., pasi me date 14.12.2015 ne llogarine e tij prane Credins Banke ka mberitur nje transferte ne vleren 135 645 Euro. Kjo transferte eshte derguar nga Litchentein po nga llogaria e tij me shenimin "mbyllje llogarie".

Nga informacioni ne burime te hapura ne emer te shtetasit te mesiperm rezulton se shtetasi R. O. eshte i perfshire ne afere korrupsioni per te ashtuquajturin "tender" i per S... U.....te s.....". Sipas te dhenave rezulton se në vitin 2009 shtetasi R. O. ishte drejtor i s... ". Ai dhe bashkeshortja e tij shtetasja M. N. jane pjese e organikes se F.M. perkatësisht pjese e seksionit te sherbimit te K. se P. dhe F..

Ne lidhje me shtetasin R. O.dhe bashkeshorton e tij shtetasen M. Kristaq N., rezulton se ka transakcione te vlerave ne menyre te permbledhur si vijon:

R. O.

1. Me date 20.04.2010 sipas kontrates nr.rep/kol/...../... i ka shitur shtetase V. Z. K. pasuri te palujtshme ne vlere 6370 000 Leke;
2. Me date 04.01.2011 ka blere nga "A....." shpk nepermjet Tirana L..... automjet ne vlere 7 909 320 Leke.
3. Me date 25.03.2014 i ka shitur shtetasit I. H.K. automjet (BMW X 6) ne vleren 50 000 Euro;
4. Me date 03.06.2014 i ka shitur shtetasit A. Q. C. automjet (BMW vleren 30000 Euro;
Me date 19.11.2014 ka marre hua nga shtetasi K. T. N. shumen 100 000 Euro;
5. Me date 10.04.2015 ka kryer nje pagese te pjesshme cash ne favor te shoqerise "D....." me NIPT J.....U sipas kontrates nr..... rep, nr. ... kol.
6. Ne intervali kohor 2010-2015 ka kryer transaksione (si terheqje, pagesa per leasing, depozitime etj) ne banka te ndryshme ne shuma qe arijne deri ne 100 000 Euro, keshtu mund te evidentojme:
7. Me date 30.03.2012 prane Credins banke ne llogari te tij eshte kryer kembim valutor ne shumen 8 424 000 Leke;
8. Me date 10.12.2012 ka terhequr nga llogaria prane BKT shumen 25000 Euro;
9. Me date 10.04.2014 ka terhequr nga llogaria prane BKT shumen 100 000 Euro me qellim blerje pasurie te paluajtshme;
10. Me date 29.09.2014 ka derdhur ne llogari prane RZB shumen 38 5000 Euro me burim te ardhurash shitje makine;

M. N.

11. Me date 07.10.2014 ka blere automjet (BMW) nga shtetasi I. P. J. ne vleren 30000 Euro;
12. Me date 17.03.2015 i ka shitur shtetasit T. J. K. automjet (BMW) ne vleren 28 000 Euro;
13. Nga verifikimi ne QKR ne emer te shtetasve te mesiper rezulton se shtetasi R. O. eshte aksioner (51 % te kuotave) ne aktivitetin tregtar "A....." shpk me NIPT L.....D. Ky aktivitet eshte themeluar me date2012 ne Tirane e me objekt te veprimtarise "Import-Eksport te produkteve disinfektuese". Aksioner gjithashtu eshte edhe shtetasi A. T., i datelindjes 15.12.19..... (.....);

Drejtoria e Pergjithshme e Parandalimit te pastrimit parave, me ane te shkreses me Nr./2, date 18.12.2015, ka Ieshuar urdherin me Nr....., per banken "CREDINS", per bllokim te perkohshem te transaksioneve te shtetasve.

Për sa më sipër egzistojnë dyshime lidhur me transkasionet e kryera si më sipër nga shtetasit R. O. dhe M.N..

Nga parashtrimi i faktit rezulton se plotësohen kushtet ligjore të përcaktuara në nenin 210 të K.Pr.Penale për vendosjen e sekuestros në mbi të gjitha llogaritë bankare të shtetasve R. O. dhe M. N. pranë B.....Sh.A.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata duke u bazuar në nenet 210 të K.Pr.Penale

VENDOSI

-Sekuestrimin e parave të ndodhura në të gjithë llogaritë bankare të shtetasve R. O. dhe M. N. në Bankën Credins Sh.A.

-Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë, sipas ligjit.

-U shpall në Tiranë sot me datë 21.12.2015 ora 15³⁰

SEKRETARE

GJYQTARI

NATASHA AZEMAJ

ALTIN SHKURTI